



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.71/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Jakup Nura, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që ti numëroj të gjitha vendvotimet në Komunën e Skenderajt, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28.12.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.01.2026, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Jakup Nura, ZP.Anr.71/2026, e datës 10.01.2026, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që ti numëroj të gjitha vendvotimet në Komunën e Skenderajt, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28.12.2025.

A r s y e t i m

Më datë 10.01.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.71/2026, të parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Jakup Nura, me të cilën pretendon për parregullsi në administrimin e numërimit dhe/ose regjistrimit të votave preferenciale brenda subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me theks të veçantë në vendvotimet e Komunës së Skenderajt, si dhe me kërkesë për rinumërim të plotë të fletëvotimeve në vendvotimet përkatëse, me qëllim të verifikimit të saktësisë së rezultateve dhe rikthimit të integritetit të procesit zgjedhor. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo ankesë parashtrohet në kuptim të nenit 106 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në kompetencat e PZAP-it sipas Rregullores Nr. 01/2025, përkatësisht nenit 13 paragrafi 12 nënparagrafi 12.1. Tutje në ankesë theksohet se në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në Republikën e Kosovës janë mbajtur më datë 28 dhjetor 2025, dhe se para këtyre zgjedhjeve, zgjedhjet e përgjithshme janë mbajtur më datë 9 shkurt 2025, dhe brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër kohore ndërmjet dy proceseve zgjedhore, ankuesi ka vërejtur një rënie drastike të numrit të votave preferenciale në shumicën e vendvotimeve të Komunës së Skenderajt, rënie e cila në shumë raste tejkalon përgjysmimin e votave të tij krahasuar me zgjedhjet paraprake. Kjo rënie, e

shpërndarë në mënyrë të përsëritur dhe gati uniforme në një numër të madh vendvotimesh të së njëjtës komunë, nuk përputhet me logjikën e sjelljes elektorale të zakonshme dhe ngre dyshime serioze për ndërhyrje eventuale në procesin e numërimit, regjistrimit apo administrimit të fletëvotimeve në vendvotimet e kësaj komune. Për më tepër dyshimi për parregullsi në Komunën e Skenderajt bëhet edhe më i arsyeshëm dhe më i argumentueshëm kur analizohet sjellja krahasuese e votës së ankuesit në komuna të tjera. Përkundër faktit se Skenderaj përbën bazen natyrore elektorale të ankuesit dhe vendin ku, në mënyrë të pritshme, do të duhej të ruhej së paku kontinuiteti i mbështetjes, rënia drastike dhe gati e përgjithësuar e votës preferenciale vërehet pikërisht aty. Në komuna të tjera ankuesi thekson se tradicionalisht nuk e ka të njëjtën peshë elektorale si në vendlindjen e tij, si Prishtina dhe Fushë Kosova, nga të dhënat krahasuese rezulton se një rënie e tillë nuk ka ndodhur, mirëpo përkundrazi, është shënuar rritje e ndjeshme e votës së ankuesit në raport me zgjedhjet e 18 shkurtit. Sipas ankuesit në këto rrethana, rezultati i deklaruar dhe i publikuar krijon dyshime të arsyeshme se nuk pasqyron domosdoshmërisht vullnetin real të votuesve në këto vendvotime, dhe se integriteti i procesit, të paktën në pjesën e numërimit dhe regjistrimit të votës preferenciale për ankuesin, dhe se kërkon verifikim të menjëhershëm me masën më të efektshme procedurale: rinumërimin. Ankuesi, përmes krahasimit të rezultateve të votës preferenciale në vendvotimet e Komunës së Skenderajt, ka konstatuar rënie të theksuar dhe të përsëritur pothuajse në çdo qendër votimi, dhe sipas ankuesit këto diskrepanca nuk shfaqen si devijime të izoluara në disa pika të veçanta, por si trend i vazhdueshëm në një numër të madh vendvotimesh, çka e bën fenomenin sistematik dhe e përforcon dyshimin se kemi të bëjmë me parregullsi që mund të kenë ndodhur në fazat e numërimit, bartjes së të dhënave, regjistrimit në formularë, ose në ndonjë fazë tjetër të administrimit zgjedhor. Për ilustrim të qartë dhe të detajuar, ankuesi paraqet krahasimet për secilin vendvotim veç e veç, duke e bërë të verifikueshme diskrepancën në mënyrë konkrete. Në Qendrën e Votimit 2101, SH.M.L. Teknike "Anton Çetta", në vendvotimin 01 ankuesi ka rënë nga 171 vota në 84 vota; në vendvotimin 02 nga 175 në 78; në vendvotimin 03 nga 131 në 73, në vendvotimin 04 nga 125 në 70; në vendvotimin 05 nga 155 në 79; në vendvotimin 06 nga 106 në 73; në vendvotimin 07 nga 88 në 52 ; Në Qendrën e Votimit 2102, SH.M.F.U "Shaban Jashari", në vendvotimin 01 nga 156 në 122, në vendvotimin 02 nga 167 në 91, në vendvotimin 03 nga 152 në 79; në vendvotimin 04 nga 165 në 63, në vendvotimin 05 nga 175 në 98. Në Qendrën e Votimit 2103, SH.M.F.U "Vëllezërit Frashëri", në vendvotimin 01 nga 197 në 129, në vendvotimin 02 nga 108 në 84. Në Qendrën e Votimit 2104, SH.M.F.U "F. Rama", në vendvotimin 01 nga 85 në 37, në vendvotimin 02 nga 115 në 66. Në Qendrën e Votimit 2105, SH.M.F.U "Ismet Rrahmani", në vendvotimin 01 nga 72 në 51. Në Qendrën e Votimit 2106, SH.M.F.U "Azem Bejta", në vendvotimin 01 nga 178 në 102, në vendvotimin 02 nga 208 në 130, në vendvotimin 03 nga 149 në 71. Në Qendrën e Votimit 2107, SH.M.F.U "Idriz Berani", në vendvotimin 01 nga 135 në 84, në vendvotimin 02 nga 142 në 76, në vendvotimin 03 nga 172 në 120, në vendvotimin 04 nga 177 në 93. Në Qendrën e Votimit 2108, SH.M.F.U "Drenica", në vendvotimin 01 nga 117 në 71, në vendvotimin 02 nga 159 në 97, në vendvotimin 03 nga 103 në 91, në vendvotimin 04 nga 172 në 103. Në Qendrën e Votimit 2109, SH.M.F.U "Dëshmorët e Qiqavicës", në vendvotimin 01 nga 272 në 144, në vendvotimin 02 nga 207 në 185. Në Qendrën e Votimit 2110, SH.M.F.U "Pavarësija", në vendvotimin 01 nga 142 në 97 . Në Qendrën e Votimit 2111, SH.M.F.U "Skender Skenderi", në vendvotimin 01 nga 144 në 100, në vendvotimin 02 nga 152 në 116. Në Qendrën e Votimit 2113, SH.M.F.U "Migjeni", në vendvotimin 01 nga 159 në 87, në vendvotimin 02

nga 104 në 83. Në Qendrën e Votimit 2114, SH.M.F.U "Ali Kelmendi", në vendvotimin 01 nga 111 në 62, në vendvotimin 02 nga 159 në 70, në vendvotimin 03 nga 71 në 67. Në Qendrën e Votimit 2115, SH.M.F.U "Shote Galica", në vendvotimin 01 nga 132 në 51, në vendvotimin 02 nga 111 në 33, në vendvotimin 03 nga 147 në 51. Në Qendrën e Votimit 2116, SH.M.F.U "Halit Geci", në vendvotimin 01 nga 190 në 35, në vendvotimin 02 nga 127 në 47, në vendvotimin 03 nga 102 në 50. Në Qendrën e Votimit 2117, SH.M.F.U "Malush Ahmeti", në vendvotimin 01 nga 190 në 71, në vendvotimin 02 nga 127 në 50, në vendvotimin 03 nga 102 në 63. Në Qendrën e Votimit 2118, SH.M.F.U "Abedin Rexha", në vendvotimin 01 nga 97 në 44, në vendvotimin 02 nga 93 në 59. Në Qendrën e Votimit 2119, SH.M.F.U "Ismet Huka", në vendvotimin 01 nga 71 në 48, në vendvotimin 02 nga 96 në 55. Në Qendrën e Votimit 2121, SH.M.F.U "Shote Galica", në vendvotimin 01 nga 58 në 23. Në Qendrën e Votimit 2122, SH.M.F.U "Kuvendi i Drenicës", në vendvotimin 01 nga 110 në 62, në vendvotimin 02 nga 103 në 53. Në Qendrën e Votimit 2123, SH.M.F.U "Elena Gjika", në vendvotimin 01 nga 116 në 67. Në Qendrën e Votimit 2124, SH.M.F.U "Abadin Rexha", në vendvotimin 01 nga 112 në 60, në vendvotimin 02 nga 112 në 79. Në Qendrën e Votimit 2125, SH.M.F.U "Abedin Rexha", në vendvotimin 01 nga 149 në 75, në vendvotimin 02 nga 159 në 119. Në Qendrën e Votimit 2126, SH.M.F.U "Vëllezërit Frashëri", në vendvotimin 01 nga 42 në 36. Në Qendrën e Votimit 2127, SH.M.F.U "Idriz Berani", në vendvotimin 01 nga 68 në 38. Në Qendrën e Votimit 2128, SH.M.F.U "Halit Geci", në vendvotimin 01 nga 70 në 48. Në Qendrën e Votimit 2129, SH.M.F.U "Halit Geci", në vendvotimin 01 nga 133 në 96. Në Qendrën e Votimit 2130, SH.M.F.U "Azem Bejta", në vendvotimin 01 nga 101 në 68, në vendvotimin 02 nga 117 në 100. Në Qendrën e Votimit 2132, SH.M.F.U "Pavarësia", në vendvotimin 01 nga 128 në 111, në vendvotimin 02 nga 140 në 124. Në Qendrën e Votimit 2132, SH.M.F.U "Drenica", në vendvotimin 01 nga 72 në 40.

Ankuesi thekson se këto të dhëna flasin vetë për një diskrepancë të rëndë, të shtrirë në gjeografinë zgjedhore të tërë komunës. Ato nuk mund të minimizohen si "luhatje normale" elektorale, sepse vetë shkalla e rënies dhe mënyra e përsëritjes në shumë pika të numërimit krijojnë bazë serioze për dyshim të arsyeshëm, i cili standard është i mjaftueshëm për të aktivizuar masat e verifikimit, sidomos kur masat janë teknike dhe jo represive, siç është rinumërimi. Për më tepër, ankuesi thekson se diferencat në vota në nivel të zgjedhjeve për deputet shpesh janë minimale dhe se ndryshimi edhe më i vogël i numrit të votave në këto vendvotime mund të jetë vendimtar për renditjen e kandidatëve brenda listës dhe për përfitimin e mandatit. Kjo nuk paraqet spekulim, por është realitet i sistemit proporcional me listë të hapur, ku një ndryshim edhe i vogël në votën preferenciale mund të ndryshojë tërësisht rezultatin individual të kandidatit. Për rrjedhojë, mos verifikimi me rinumërim do të krijonte rrezik serioz që mandati të mos reflektojë vullnetin real të votuesve, por një rezultat potencialisht të kontaminuar nga gabime apo ndërhyrje. Ankuesi thekson se Neni 106 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme e vendos qartë parimin se para certifikimit të rezultateve përfundimtare dhe deri në përmbylljen e procedurave ankimore, procesi është i hapur për verifikime korrigjuese. Po ashtu, kompetencat e PZAP-it për të ndërmarrë masa që sigurojnë ligjshmërinë dhe integritetin e procesit, përfshirë urdhërimin e rinumërimit, burojnë nga rregullorja procedurale për ankesat, e cila synon të sigurojë zgjidhje efektive, të shpejtë dhe të orientuar drejt provës. Pala ankuese ka kërkuar nga PZAP që të aprovohet si e bazuar ankesa, si dhe të urdhërohet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të rinumërojë fletëvotimet në të gjitha vendvotimet e Komunës së Skenderajt, si më lartë shënuar në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, të datës 10.01.2026, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), Procedurën e Qendrës si Numërimit dhe Rezultateve, ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese se, në krahasim me zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 9 shkurt 2025, ka pasur më pak vota në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025, theksojmë se një krahasim i tillë nuk mund të merret për bazë dhe as të konsiderohet i qëndrueshëm, për faktin se zgjedhjet e datës 9 shkurt 2025 dhe zgjedhjet e datës 28 dhjetor 2025 kanë qenë procese të ndryshme zgjedhore, të zhvilluara në rrethana të ndryshme, përfshirë afatin e mbajtjes së zgjedhjeve, natyrën e tyre (zgjedhje të rregullta dhe zgjedhje të parakohshme), numrin e subjekteve politike pjesëmarrëse, përbërjen e listave zgjedhore, kandidatët, si dhe numrin e votuesve që kanë marrë pjesë në procesin e votimit. Rezultatet e zgjedhjeve të datës 9 shkurt 2025 nuk mund të shërbejnë si pikë referimi për vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme të datës 28 dhjetor 2025, pasi bëhet fjalë për procese të ndryshme zgjedhore me rrethana të ndryshme. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese, të cilat mbështeten në pritshmërinë e tij subjektive për të marrë një numër më të madh votash, theksojmë se pritshmëritë personale ose subjektive të kandidatëve nuk përbëjnë bazë ligjore për vlerësimin e rregullsisë së procesit zgjedhor dhe as për kontestimin e rezultateve zgjedhore përderisa procesi i votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet nënligjore të lartcekura dhe përkatëse. Sa i përket pretendimeve të palës, për dyshimet dhe parregullsitë në vendvotimet e komunës së Skenderajt, nuk qëndrojnë sepse, bazuar në Raportin e Dhomës Operative të KQZ, për ditën e zgjedhjeve, nuk është evidentuar ndonjë parregullsi në procesin e votimit apo numërimit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi lidhur me parregullsitë në numërimin e votave dhe me asnjë provë konkrete nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulim të votave, rrjedhimisht pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota, nuk nënkupton se ka pasur parregullsi dhe mungesë të votave. Pra, nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të dëshmonin pretendimet e saj. Andaj pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Skenderaj (shih të bashkangjitur konfirmimin e ZEKKZ), aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 31.12.2025 në ora 14:00, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 10.01.2026. Pra nuk është brenda afatit

ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit "Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR i dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar". Sa i përket pretendime të palës ankuese, lidhur me rezultatet zgjedhore, ju njoftoj se, KQZ ende nuk ka bërë shpalljen e rezultateve zgjedhore. KQZ, në pajtim me nenin 105.3 dhe 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, shpall rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), fletëvotimeve nga votimi me kusht, fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta dhe fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe pas të gjitha vërejtjeve që i përkasin votimit dhe numërimit, të cilat janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP) dhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, ku rezultati i publikuar është i ankueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, vëren se ankesa është e palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimet e palës ankuese të paraqitur kundër rezultateve përfundimtare të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vendvotimet në Komunën e Skenderajt, me të cilën i referohet parregullsive në administrimin e numërimit dhe/ose regjistrimit të votave preferenciale brenda subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me theks të veçantë në vendvotimet e Komunës së Skenderajt, si dhe me kërkesë për rinumërim të plotë të fletëvotimeve në vendvotimet përkatëse, me qëllim të verifikimit të saktësisë së rezultateve dhe rikthimit të integritetit të procesit zgjedhor, e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është e palejueshme.

Pretendimet e tjera të parashtresës të ankesave PZAP, nuk i ka shqyrtuar, sepse fillimisht ankesa ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme, Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse në këtë fazë, pasi që aspekti i palejueshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohet.

Me nenin 106 paragrafi 3 i Ligji Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.

Po ashtu me nenin 105 të LJP është përcaktuar se "*Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*"

Gjithashtu me nenin 115 LJP është përcaktuar se, "*PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.*" Kurse neni 13 i Rregullores

Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohen se *"PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim"*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, PZAP erdhi në përfundim se ankesa është e palejueshme, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës të kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e ankesës i cili është dyzet e tetë (48) orë, nga shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, rezultat ky i cili ende nuk është shpallur nga KQZ.

Ndërsa lidhur me pretendimet që pala ka ngritur lidhur me administrimin e punës në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN). Sipas nenit 105 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat që kanë të bëjnë me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i ndodhjes së shkeljes së supozuar. Andaj, edhe sa i përket këtyre pretendimeve vlerësohet se ankesa është pas afatshme për arsye se procesi i numërimit dhe administrimit të punës së QKN në komunën e Skenderaj është përmbyllur me datën 31.12.2025 në ora 14:00, ndërsa ankesa është paraqitur në PZAP, me datë 10.01.2026.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 115.1 nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.71/2026, datë 12.01.2026

Kryesues i Panelit,

Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.